



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:090161

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05543451

PKR.nr.8/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Fatime Dërmaku e Ertan Sejfulla - anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarve: B.H. e N.J., të akuzuar për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 138, par. 2, lidhur me par. 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës – në vijim KPPK, ndërsa i akuzuari N.J., edhe për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut – tani Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.232-2/2009, të datës 04.08.2009, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 16.02.2024 dhe 02.04.2024, në të cilin ishin të pranishëm: prokurorët e shtetit Besa Limani e Bashkim Zeqaj, të akuzuarit B.H. me mbrojtësin e tij Naim Aliu, i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe N.J. me mbrojtësin e tij av. Mexhid Sylja sipas autorizimit, si dhe dëshmitarët I.M., B.B. dhe H.A., pas shqyrtimit gjyqësor, të njëjtën ditë, me datë 02.04.2024, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I.

Ndaj të akuzuarve:

B.H., i biri i R. dhe Z., e vajzërisë R., i lindur me datë ..., në Gj., me banim në fshatin K., Komuna Viti, ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-baba i katër fëmijëve, i punësuar - realizon pagë mujore rreth 400 euro, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës dhe

N.J., i biri i I. dhe N., e vajzërisë A., i lindur me datë ..., në fshatin Sh., Komuna Podujevë, rruga "...", me numër personal ..., ka të kryer Fakultetin Juridik dhe studimet master, i martuar-baba i katër fëmijëve, i punësuar - realizon pagë mujore 619 euro, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363, par. 1, nënpar. 1.3, të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale,
REFUZOHET AKUZA

S e p s e: deri më 07.04.2009, me qëllim për të fituar drejtpërdrejt ose tërthorazi dobi pasurore a financiare në mënyrë të kundërligjshme, kanë nxjerrë nga Kosova persona të ndryshëm, për në shtetet perëndimore si në Zvicër, Francë, Slloveni dhe vende tjera, duke ju siguruar dokumente të falsifikuara si dokumente të udhëtimit, leje qëndrimi, letërnjoftime, pasaporta dhe viza hyrëse, për çka nga secili person kanë përfituar shuma prej 1500 deri në 3500 euro, ashtu që tani i akuzuari B.H. ka rregulluar dhe shitur dokumente të falsifikuara, si leje qëndrimi zvicerane personit G.K. për shumën prej 2500 euro, i cili në tentim për të kaluar pikën kufitare në Aeroportin e Prishtinës me datën 15.03.2008 është ndalur nga policia, pastaj i njëjti ka ndërmjetësuar me tani të gjykuarin S.R. për rregullimin e dokumenteve edhe për A.T. dhe B.P., ndërsa i pandehuri S.R. ka kontakte të shumta telefonike me të pandehurit S.1. e S.2., ku shumica e kontakteve kanë të bëjnë për rregullimin e dokumenteve dhe mënyrën e organizimit të udhëtarëve, ndërsa tani i akuzuari N.J., duke qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës në Aeroportin e Prishtinës, në kontrollin e dokumenteve në bashkëveprim me të pandehurit tjerë, posaçërisht me tani të gjykuarin S.M.1., me të cilin ka pasur kontakte të shpeshta, e të cilin me datë 03.04.2009 e ka thirrur në telefon dhe nga ai ka kërkuar dokumente të falsifikuara siç ka thënë “për dy shokë të tij asi siç i ka marrë Iliri”, e gjatë komunikimeve kanë përdorur fjalën “kerr”, kur ishte fjala për viza gjegjësisht për pasaporta, duke biseduar për termin, kohën që duhet pritur, çmimin prej 2000 euro dhe ndarjen e fitimit, si dhe ka ndihmuar tani të gjykuarin S.M.1. që të dërgoj persona jashtë Kosovës përmes Aeroportit të Prishtinës, ndërsa si pjesëtar i policisë edhe pse e ka kuptuar veprimtarinë kriminale të tani të gjykuarit S.M.1., nuk ka reaguar ashtu siç e ka obliguar ligji, por përkundrazi ka bashkëvepruar me të, me qëllim përfitimi material të kundërligjshëm,-

- me këtë, kishin për të kryer veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 138, par. 2, lidhur me par. 1 të KPPK,

II.

Ndaj të akuzuarit N.J., me të dhëna personale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi,

Konform nenit 362, par. 1, nënpar. 1.3 të KPP,

REFUZOHET AKUZA

S e p s e: deri më 07.04.2009, ka ndihmuar tani të gjykuarin S.M.1. që të dërgoj persona jashtë Kosovës përmes Aeroportit të Prishtinës, ndërsa si pjesëtar i policisë edhe pse e ka kuptuar veprimtarinë kriminale të tani të gjykuarit S.M.1., nuk ka reaguar ashtu siç e ka obliguar ligji, por përkundrazi ka bashkëvepruar me të, me qëllim përfitimi material të kundërligjshëm,-

- me këtë, kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK
- **pasi që me datë 07.04.2019, ka arritur dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të ndjekjes penale për veprat penale si më lart.**
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

ARSYETIMI

Prokuroria e Qarkut – tani Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.232-2/2009, të datës 04.08.2009, ka akuzuar të pandehurit: S.M.1.; S.M.2.; Sh.K.; S.R.; N.M.; D.D.; B.H. dhe N.J., të akuzuar për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 138, par. 2, lidhur me par. 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës – në vijim KPPK dhe Falsifikimi i dokumentit nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës - KPPK, Sh.K. dhe I.M., për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par.2, të KPK; A.A.; G.K.; M.M. dhe Sh.B., për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumentit nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK ndërsa i akuzuari N.J., edhe për shkak të veprës penale Shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339, par. 3, lidhur me par. 1 të KPPK.

Kjo gjykatë, me aktvendimin PKR.nr.372/2009 të datës 10.10.2018 ka hedhë pjesërisht aktakuzën e Prokurorisë së Qarkut – tani Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.nr.232-2/2009, të datës 04.08.2009 dhe ka pushuar procedurën penale për të akuzuarit: S.M.1.; S.M.2.; Sh.K.; S.R.; N.M.; D.D.; B.H.; N.J.; A.A.; G.K.; M.M. dhe Sh.B., sepse ndjekja penale për veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1, të KPPK, të paraqitur si në pikën I dhe III të dispozitivit të aktakuzës, për të cilën të pandehurit janë akuzuar, ka arritur dyfishi i afatit të parashkrimit të ndjekjes penale me datë 07.04.2015. Po ashtu, me të njëjtin aktvendim, edhe për të akuzuarit Sh.K. e I.M., gjykata ka hedhë aktakuzën për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par.2 të KPPK, të paraqitur si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës, sepse ndjekja penale, për të cilën të pandehurit janë akuzuar, është amnistuar sipas Ligjit nr. 04/L-209, për Amnistinë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 28.12.2023, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit S.M.1., S.M.2., Sh.K., S.R., N.M. dhe D.D. kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe janë deklaruar fajtorë për veprën penale për të cilën janë akuzuar, ndërsa të akuzuarit B.H. dhe N.J. janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale për të cilat janë akuzuar, e pasi gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë për të akuzuarit që kanë pranuar fajësinë, kryetari i trupit gjykues pasi ka marrë mendimin e palëve në procedurë për veçimin e procedurës penale për të akuzuarit B.H. dhe N.J., ka marrë aktvendim me të cilin ka veçuar procedurën penale ndaj tyre, për shkak të efikasitetit të përfundimit të procedurës penale ndaj të akuzuarve që kanë pranuar fajësinë, përkatësisht me qëllim të një gjykimi të drejtë dhe në një afat sa më të shkurtër të paraparë me dispozitat ligjore në fuqi dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në fjalën hyrëse prokurori i shtetit ka deklaruar se prokuroria ka ushtruar aktakuzën PP.232-2/2009 kundër të pandehurve në sallë në drejtim të veprës penale kontrabandim e cila është ri kualifikuar, duke shtuar se provat përmes të cilave është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprat penale, janë provat e mbledhura gjatë zhvillimit të hetimeve dhe të propozuara në aktakuzë e të cilat do të administrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor, e sipas të cilave do të vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat ngarkohen.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, pasi që të pandehurit B.H. dhe N.J. kanë kryer veprat penale si në hyrje të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor dhe nga provat, e sidomos nga ekzaminimet e përgjimeve që janë bërë vërehet roli i tyre në kryerjen e veprave penale, ku i pandehuri B. edhe në deklaratën e tij ka theksuar rolin e tij se si është njohur më të pandehurin S., se si kanë shkuar në kafeterinë “S...” dhe si kanë biseduar me L. për të rregulluar dokumentet e Zvicrës, e aty ka bërë marrëveshjen për rregullimin e dokumenteve, për të cilën ka paguar 2500 euro, derisa në rolin e

tij të cilin e ka pasur i njëjti nuk e ka mohuar ma parë se ka marrë para për rregullimin e dokumenteve nga A.T., e prapë mbi bazën e provave të prezantuara shihet një rol aktiv i këtij të pandehuri ndërsa i pandehuri N.J. nga raportet e përgjimeve shihet po ashtu se ka pasur rolin shumë aktiv në cilësinë e policit, pasi ky i pandehur nuk e mohon faktin se e ka njohur të pandehurin S.1., e po ashtu thekson se të njëjtin e ka njohur nga fakti i shitjes së një veture, si dhe ka thënë se ka biseduar në telefon me të lidhur me pagesën që nuk ia ka bërë në tërësi, e po ashtu në raportet e përgjimeve shihet qartë se të pandehurit S.1. dhe N. kanë pasur një komunikim lidhur me punën. Pastaj, prokurori i shtetit ka thënë se është e vërtetë se siç ka thënë ky- N. “S.1. e kam njoftuar kur ka qenë i sëmure”, pastaj i njëjti thekson se ndonjëherë me S.1. ka pirë kafe në Prishtinë por se asnjëherë nuk ka dyshuar se S.1. merret me ndonjë punë të dyshimtë, duke shtuar se nga tërësia e provave dhe nga deklarimi i tij në fazat e mëhershme të procedurës penale mund të theksohet se i pandehuri N. me veprimet e tij ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale, duke i propozuar gjykatës që në rastin konkret të merr parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese për të pandehurit, e pastaj të njëjtit ti shpall fajtorë dhe t’i dënoj sipas ligjit.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarit B.H., av. Naim Aliu ka deklaruar se sa i përket të mbrojturit të tij i kundërshton në tërësi pretendimin e akuzës se i njëjti ka kryer veprën penale e cila i vihet si barrë për arsye se i njëjti në atë kohë ka qenë vetë i interesuar për të dalë jashtë vendit dhe kontaktet që i kishte pasur i kishte siguruar për vete e jo për tu marrë me gjëra për të cilat ngarkohet me vepër penale, duke theksuar se pa dyshim që ne jemi njerëz dhe me rastin kur personi të cilit i kishte dhënë kontaktin – G., i mbrojturi i tij i kishte treguar për vete se është duke u interesuar të siguroj një dokument udhëtimi, por atë nuk kishte arritur ta bëjë në atë kohë për arsye sepse nuk kishte mjete financiare edhe në transkripta telefonike po thuajse askund nuk vërehen biseda të tij me ndonjërin nga të akuzuarit e tjerë të cilët kishin pranuar fajësinë. Pastaj, mbrojtësi i të akuzuarit ka theksuar se pa dyshim ata të cilët kanë qenë të infiltuar në mënyrë të singjertë e kanë pranuar fajësinë, andaj konsideron se akuza e ngritur në drejtim të të mbrojturit të tij është e pabazuar dhe si të tillë e kundërshton në mungesë të provave.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, mbrojtësi i të akuzuarit B.H., ka deklaruar se aktakuza ishte ngritur kundër shumë të akuzuarve dhe prokuroria nuk kishte arritur që të siguroj prova për të vërtetuar aktakuzën në raport me të mbrojturin e tij, me arsyetim se ka pranuar provat të cilat askund në mënyrë decidive nuk kanë hasur në veprime konkrete që inkrimojnë të akuzuarin B.H., përkatësisht që i njëjti të ketë kontribuar në ndonjë aspekt në kryerjen e veprës penale e cila i vihet si barrë dhe se gjatë shqyrtimi gjyqësor kemi dëgjuar edhe disa dëshmitarë të cilët asnjëherë nuk e kishin dëgjuar emrin e të mbrojturit të tij e as që e njihnin atë, ndaj mbi këtë bazë, gjykatës i ka propozuar që të njëjtin ta liroj nga akuza në mungesë të provave.

Në fjalën hyrëse i akuzuari B.H. ka deklaruar se e përkrah fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij. Ndërsa në fjalën përfundimtare i akuzuari H. ka deklaruar se pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarit N.J., av. Mexhid Sylja ka deklaruar se aktakuzën më të cilën është akuzuar i mbrojturi i tij e ka lexuar me dhjetëra herë deri sot por nuk ka mundur të hasë në asnjë provë që mbështet pretendimin e prokurorisë se i mbrojturi i tij ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, duke shtuar se kjo nuk u dëgjua as në fjalën hyrëse të prokurorit por në mënyrë të përgjithësuar prokuroria pretendon se me provat e mbledhura gjatë hetimeve është vërtetuar dyshimi i bazuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprat penale. Pastaj, mbrojtësi Sylja ka thënë se gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, gjykata do të bindet se pretendimet e paraqitura nga ai si avokat mbrojtës janë të bazuara ngase aktakuza nuk ka mbështetje në asnjërin prej provave të propozuara.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, mbrojtësi i të akuzuarit N.J. ka deklaruar se nga fillimi i kësaj procedure - ngritjes së aktakuzës, të njëjtën e ka kundërshtuar si në aspektin juridik sa i përket cilësimit të veprës penale edhe në aspektin faktik, pasi që sa i përket cilësimit juridik të veprës penale e ka theksuar dhe e rithekson se në bazë të përshkrimit faktik që i bën prokuroria në dispozitivin e aktakuzës, aktakuza është në kundërshtim me vetveten, pasi nuk ka arritur që gjykatës t'i ofroj prova bindëse me të cilat do të mbështetej dyshimi i bazuar mirë apo përtej dyshimit të bazuar se N.J. ka ndërmarrë çfarëdo veprimi që e paraqet figurën e veprës penale që i vihet në barrë dhe se në pjesën ku përshkruhen veprimet e të mbrojturit të tij, si veprime që kinse i ka ndërmarrë i mbrojturi i tij pretendohet se ai ka bashkëvepruar me të pandehurit tjerë, e pastaj veçanërisht me të pandehurin S.1., por mungon përshkrimi i këtij bashkëpunimi, mënyra se si ka bashkëpunuar, veprimet që i ka ndërmarrë dhe rrethanat tjera të nevojshme, duke konsideruar se konstatimet në dispozitiv të aktakuzës se kinse i mbrojturi i tij ka kërkuar dokumentet e falsifikuara – citat nga aktakuza, për dy shokët e tij pa u specifikuar se për çfarë dokumentesh është fjala, kush janë personat që iu kanë dedikuar ato dokumente, a janë siguruar ato dokumente, a ka ndodhur kontrabandimi, mbrojtësi mendon se është konstatim i përgjithësuar dhe nuk kemi të bëjmë me konstatim të vërtetuar por me supozim se kinse ka mundur të ndodh diçka, derisa tutje me të njëjtin dispozitiv përmendet fjala viza pa pasur asnjë provë që e mbështet këtë pretendim, pastaj thuhet gjegjësisht pasaporta, pa e pasur të qartë nëse është fjala për vizë apo pasaportë dhe në vijim duke u munduar që ta mbështet pretendimin kinse i mbrojturi i tij e ka ndihmuar të pandehurin S.1.. Po ashtu, mbrojtësi Sylja ka thënë se nga përfaqësuesi i aktakuzës, në fjalën përfundimtare dëgjuam arsyetimin se këto pretendime mbështeten në faktin se i mbrojturi i tij e ka njohur të pandehurin S.1., kinse e ka njoftuar se ka qenë i sëmure, ka pirë kafe në Prishtinë me të dhe se këto kanë qenë veprimet me të cilat janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se gjatë këtij procesi gjyqësor nuk kemi mundur ta dëgjojmë asnjë dëshmitarë që ka përmendur të mbrojturin e tij në çfarë do mënyre se ka ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me kontrabandimin apo sigurimin e dokumenteve për këtë qëllim, dhe se konstatimi i përgjithësuar duke përmendur fjalën kontrabandim në vazhdimësi pa u ndërlidhur me emrin e të mbrojturit të tij në çfarëdo forme apo mënyre, është krejtësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa pranueshëm juridikisht, me arsyetim se i mbrojturi i tij nuk ka ndërmarrë asnjë veprim dhe nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale, edhe për faktin se i njëjti ka punuar në pjesën ku kontrollohet dokumentacioni i personave që vijnë në Kosovë e po ashtu edhe faktin se i mbrojturi i tij me vetiniciativën e eprorëve të tij qe plot 11 vite është duke punuar në të njëjtin vend të punës, e kjo flet se vlerësimet e brendshme në Policinë e Kosovës kanë qenë të tilla se nuk ka arsye që i mbrojturi i tij të qëndroj larg vendit të tij të punës. Në fund të fjalës së tij, mbrojtësi Sylja ka thënë se me provat e administruara nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, andaj ka propozuar që konform nenit 364 par. 3 të KPP të lirohet nga akuza.

Në fjalën hyrëse i akuzuari N.J. ka deklaruar se e përkrah fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij. Ndërsa, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shtuar se vëllai i tij tani i ndjerë F.J., e ka pasur një servis për rregullimin e veturave dhe në atë kohë kanë qenë mbajtës të familjes, kanë pasur shtëpinë të djegur, e pas orarit të punës e ka ndihmuar vëllain, derisa përmes vëllait të tij e ka njohur S.1., nga i cili vëllai i tij ka blerë një veturë por edhe ia ka rregulluar veturat S.1. Pastaj, i akuzuari N.J. ka thënë se me sinqeritet dhe me bindje, asnjëherë dhe në asnjë mënyrë nuk e ka ndihmuar as S.1. e asnjë person tjetër që ta kaloj në mënyrë ilegale kufirin gjatë udhëtimit në aeroport, duke theksuar se gjatë karrierës së tij asnjëherë nuk ka pasur as më të voglën masë disiplinore, por gati çdo vit ka pranuar mirënjohje dhe medalje për besnikëri gjatë shërbimit në polici, e sa i përket periudhës 2007-2009 ka punuar polic në kontroll të pasaportave në arritje dhe edhe po të kishte dashur t'i ndihmoj dikujt në dalje, nuk ka pasur kompetencë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar dëshmitarët I.M., B.B. dhe H.A., janë lexuar dëshmitë e dëshmitarëve I.M. e V.B. dhe janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë, e të paraqitura si në vijim:

Dëshmia e dëshmitarit I.M., i cili nën betim, në pyetje nga prokurori i shtetit është përgjigjur se e njeh të pandehurin N.J. pasi të njëjtën e ka pasur dhe akoma e ka fqinj në fshat, përkatësisht janë rritur bashkë, duke shtuar se nuk i kujtohet që në vitin 2009 të ketë biseduar për ndonjë shumë parash me N.J. Pastaj, dëshmitari M. ka pohuar se e ka njohur S.I.M., pasi i njëjti është fqinj i dajave të tij dhe se në vitin 2009 ka marrë vizë në Ambasadën Sllovene në Shkup, pasi ka aplikuar në mënyrë të rregullt, ka pritur 2-3 muaj derisa i ka dalë viza, duke shtuar se në atë kohë është marrë me shitblerjen e veturave e për këtë ka bashkëpunuar me vëllain e N.J.t, tani të ndjerin F.J. dhe ka mundësi të ketë biseduar me N.J. dhe S.M.I. për ndonjë veturë, por personin me emrin E. i cili ka qenë nga Shkupi nuk e njeh as si emër, e pas ballafaqimit nga prokurori i shtetit me deklaratën e dhënë në polici ku ka thënë se në një rast përmes S.I. është takuar me personin nga Shkupi për marrjen e vizës sllovene për të cilën ka paguar 1700 euro, dëshmitari I.M. ka theksuar se para nuk i ka dhënë askujt, përveç pesë euro që ka paguar në ambasadë për ta ngjitur vizën.

Dëshmia e dëshmitarit B.B., i cili nën betim, në pyetje nga prokurori i shtetit është përgjigjur se e njoh personin M.M., i cili e ka motrën të martuar të fqinji i tij H.M. por se nuk ka njohuri nëse në atë kohë M.M. është pajisur me ndonjë vizë. Pasi prokurori i shtetit e ka ballafaquar dëshmitarin B. me deklaratën e dhënë në polici ku ka thënë “dokumentet e M.M. i ka rregulluar një person tjetër nga fshati Ll., Komuna Podujevë dhe e ka pseudonimin H.”, dëshmitari B.B. ka thënë se nuk e di kush është personi me pseudonimin “H.”, duke shtuar se e di se H. i thoshin por emrin nuk ia di.

Pastaj, prokurori i shtetit ka thënë se meqenëse i akuzuari S.I. sipas aktakuzës në pikën I ia ka rregulluar dokumentet M.M., nuk ka pyetje për dëshmitarin B.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit B.H., av. N.A., dëshmitari B.B. është përgjigjur se nuk e njeh asnjë person me emrin B.H. dhe se personin e ulur afër tij (dëshmitari drejtohet drejtë të akuzuarit B.H.) sot po e sheh për herë të parë, duke shtuar se mund të jetë ndonjë keqkuptim sepse këta dy të akuzuar sot për herë të parë po i sheh dhe kurrë në jetë nuk i ka takuar.

Dëshmia e dëshmitarit H.A., i cili nën betim, në pyetje nga prokurori i shtetit është përgjigjur se i ka tre djem, njëri nga ta – A. gjendet në Zvicër prej më shumë se 10-15 vitesh dhe atje ka shkuar ashtu siç kanë shkuar edhe të tjerët - pa letra, duke theksuar se tani nuk i kujtohet nëse biri i tij A. ka shkuar në Zvicër me aeroplan apo në rrugë tokësore dhe nuk e di sa ka paguar për këtë udhëtim.

Prokurori i shtetit e ka ballafaquar dëshmitarin H.A. me deklaratën e dhënë në polici me datë 08.01.2009 ku ka thënë “djali e ka bërë marrëveshjen më atë person që pasi të mbërrij në Zvicër të vjen te shtëpia dhe t’i merr paratë në shumë prej 3500 euro të cilat i kam paguar unë”, dëshmitari H.A. ka thënë se askujt nuk i ka paguar para dhe se nuk i njeh personat B.H. e N.J., dhe se biri i tij A. nuk i kishte treguar nëse ka arritur ndonjë marrëveshje me dikë që ai të shkoj në Zvicër.

Dëshmia e dëshmitarit I.M., i cili ka deklaruar se është takuar me B.B. me të cilin kanë shkuar në Sllatinë pasi vëllai i tij donte të shkonte për në Zvicër, pastaj kanë qëndruar në motel “A.” e derisa ai kishte shkuar në tualet, kur ishte kthyer në tavolinë kishte gjetur edhe një person tjetër të cilin nuk e njohte, e i cili ia ka dhënë një dokument vëllait të tij, M., e i cili person ishte

rreth tridhjetë vjeçar, jo i plotë, biond, i gjatë rreth 1.80 metra, me rroba serioze dhe pa kravatë, duke shtuar se biseda ka qenë me zë të ulët dhe ai nuk është inkuadruar fare në bisedë, e pastaj me veturën e B.B.t kanë shkuar në aeroport, me ç'rast vëllai i tij e ka vulosë biletën dhe ka hyrë brenda, ndërsa ky - dëshmitari me B.B. janë kthyer për në M. Pastaj, dëshmitari I.M. ka thënë se kjo vizë vëllait të tij i ka kushtuar 3500 euro, të cilat i ka mbajtur dëshmitari derisa vëllai i tij të shkoj në Zvicër e pastaj t'ia jap B.B., por ato para nuk ia ka dhënë atij, pasi vëllai nuk e kishte lajmëruar akoma se kishte mbërritur në banesë.

Dëshmia e dëshmitarit V.B., i cili ka deklaruar se ka ndërmjetësuar në rastin e falsifikimit të personi A.A., të cilit ia ka dhënë numrin e telefonit të S.1., të cilin e kishte marrë në Tetovë nga një person që e quanin T., duke shtuar se edhe atij i duheshin dokumente për të udhëtuar jashtë Kosovës por S.1. nuk i kishte dhënë ndonjë dokument e as që ishte takuar me të, përveçse kishte biseduar në telefon dy herë me të, por mesazh nuk i kishte shkruar.

- Raportet nga transkriptet e bisedave telefonike;
- Vërtetimet mbi marrjen e sendeve të datave 26.01.2008, 12.03.2008, 15.03.2008 dhe 07.04.2009;
- Raportet mbi ekzaminimin e dokumenteve të falsifikuara- certifikatat përkatëse, leje qëndrimet zvicerane, letërnjoftime dhe pasaporta jugosllave, maqedonase dhe të UNMIK-ut;
- Raportet e vëzhgimit, fotografimit dhe hetimit;
- CD- e përgjimit të bisedave telefonike të rastit;
- Ekzaminimi i kompjuterëve dhe telefonave celularë, dhe
- Foto dokumentacioni.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Pas analizimit dhe vlerësimit të dëshmive të dëshmitarëve dhe provave materiale, trupi gjykues konform nenit 360, par. 2 të KPP, njëzëri ka vendosur ta bëj rikualifikimin e veprës penale pasi ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret në veprimet e tani të akuzuarve B.H. e N.J., nuk përmbushen elementet e veprës penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 164, par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK sepse sa i përket të pandehurit B.H. në aktakuzë thuhet se “ka rregulluar dhe shitur dokumente të falsifikuara si leje qëndrimi Zvicerane personit G.K., i cili gjatë kalimit të pikës kufitare në aeroportin re Prishtinës është ndaluar nga policia, pastaj i njëjti-B.H. ka ndërmjetësuar me të pandehurin S. në rregullimin e dokumenteve edhe për A.T. dhe B.P.” përkatësisht roli i të akuzuarit B.H. ka qenë prodhimi dhe sigurimi i dokumenteve të rrejshme të udhëtimit. Po ashtu, edhe për të akuzuarin N.J., prokuroria pretendon se i njëjti ka kërkuar nga tani i dënuari S.M.1. që të siguroj dokumente të falsifikuara për dy shokët e tij, andaj mbi këtë bazë, trupi gjykues ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 164, par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK, në veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 138, par. 2, lidhur me par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, për të cilën parashihet dënim me burgim deri në 5 vite, ndërsa bazuar në dispozitën e nenit 90 par. 4 të Kodit të Përkohshëm Penal, trupi gjykues ka ardhur në përfundimin se ka arritur dyfishi i afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, pasi që sipas aktakuzës veprimi inkriminues është ndërmarrë deri me datë 07.04.2009, ndërsa për veprën penale të ri kualifikuar është paraparë afati i parashkrimit prej 5 vitesh, ndërsa dyfishi i këtij afati 10 vite, ashtu që, parashkrimi i ndjekjes penale ka arritur me datë 07.04.2019.

Po ashtu, edhe për të akuzuarin N.J., bazuar në nenin 3 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, i cili parasheh se ndaj kryesit zbatohet ligji më i favorshëm në rastet kur ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, andaj mbi këtë bazë trupi gjykues ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale Shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339, par. 3, lidhur me par. 1 të KPPK për të cilën parashihet dënim me burgim prej 1-8 vite, në veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, par. 1 të KPK, për të cilën parashihet dënim me burgim prej 6 muaj deri në 5 vite, ndërsa bazuar në dispozitën e nenit 106 par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK, trupi gjykues ka ardhur në përfundimin se ka arritur dyfishi i afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, pasi që sipas aktakuzës veprimi inkriminues është ndërmarrë deri me datë 07.04.2009, ndërsa për veprën penale të ri kualifikuar është paraparë afati i parashkrimit prej 5 vitesh, ndërsa dyfishi i këtij afati është 10 vite, ashtu që, parashkrimi i ndjekjes penale ka arritur me datë 07.04.2019.

Vendimi për shpenzimet procedurale u mor në bazë të nenit 454, par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lart, në bazë të neneve: 90, par. 1, pika 4 të KPPK; 106, par. 1, pika 4 të KPRK, si dhe 363, par. 1, nënpar. 1.3 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 04.04.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.8/2024, datë 02.04.2024.

Bashkëpunëtoreshë profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.